

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi, kryetar i kolegjit, Ramë Hyseni dhe Fejzullah Rexhepi, anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) sh.a. Vala në Prishtinë, të cilën e përfaqëson e autorizuar H.S., juriste e diplomuar, kundër të paditurit Xh.(I.)G., nga Prishtina, lagja: Ulpiana ..., për shkak të pagesës së borxhit, vlera e kontestit 615.75 Euro, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 985/12, të dt. 16.09.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **25.02.2016**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) sh.a. Vala në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 985/12, të dt. 16.09.2014, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 985/12, të datës 16.09.2014, paragrafi I është miratuar pjesërisht kërkesëpadia e paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) sh.a. Vala në Prishtinë dhe është detyruar i padituri Xh.(I.)G., nga Prishtina, lagja: Ulpiana ..., që paditëses, në emër të borxhit ti paguaj shumën prej 82.75 Euro, me kamatë vjetore prej 3.5% prej datës 16.09.2014, e deri në pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm, ndërsa me paragrafin II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses përtej shumës së aprovuar si në pikën një të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë në shumë prej 530 Euro, në emër të borxhit si të pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësja, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aktgjykimi i atakuar ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje ose kërkesëpadinë a paditëses ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, të LPK-së gjeti se :

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me dt. 16.07.2009, ka parashtruar propozim për përmbaram kundër debitorit, në bazë të dokumentit autentik faturës Nr.070103005891 të dt.21.09.2009, me propozim që debitori të paguan në emër të shfrytëzimit të shërbimeve në numrin e telefonit 044-181-992, t'ia paguajë shumën prej 615.75 euro, me kamat prej 3.5%, duke filluar nga 02.02.2008, e gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet faktike të përmbaramit nën kërcënim të përmbaramit të dhunshëm. Me aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë EDA.nr.2760/09 të dt. 16.07.2009, është caktuar përmbarami i propozuar nga kreditori, mirëpo debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar kundërshtim duk theksuar se është keqpërdorur numri i telefonit dhe borxhi është parashkruar, me propozim që propozimi të trajtohet si padi.

Kështu gjykata e shkallës së parë me konkluzionin EDA.nr.2760/09 të datës 28.03.2012, e ka anuluar aktvendimin me të cilin e ka caktuar përmbaramin dhe propozimin për përmbaram e ka trajtuar si padi me të cilën e ka filluar procedurën kontestimore. Në shqyrtimin kryesor të datë 16.09.2014, i cili është mbajtur në mungesë të paditurit i cili përkundër faktit se ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt që vërtetohet nga fletë kthesa të cilën e ka pranuar me datë 11.07.2014, i autorizuari i paditësit ka theksuar se mbetet pranë kërkesëpadisë duke shtuar se i padituri ka qenë në marrëdhënie kontraktuese me paditësin për shfrytëzimin e telefonisë mobile "Vala" për periudhën shkurt 2008-qershor 2008 ka kërkuar nga gjykata që ta aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë dhe ta detyrojë të paditurin që të përmbush obligimin lidhur me borxhin për shpenzimet e impulseve telefonike me kamatë ligjore të lartcekur.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në këtë gjendje faktike ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses dhe duke e detyruar të paditurin që paditëses në emër të shfrytëzimit të shërbimeve t'ia paguaj shumën prej 82.75 Euro, me kamatë vjetore prej 3.5%, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërkaq me paragrafin e II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses në shumë prej 530Euro, me arsyetim se e njëjta është parashkruar.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika (b),(g),(j),(k) dhe (m) të LPK, e të cilat i vlerëson sipas detyrës zyrtare gjykata e shkallës së dytë në bazë të nenit 194 të LPK.

Janë të pa bazuara dhe të pa qendrueshme pretendimet ankimore të paditëses në lidhje me atë se aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të ligjit të procedurës kontestimore dhe ligjit mbi marrëdhëniet juridike detyrimore konkretisht nenit 378 të LMD për shkak se i padituri ka kryer pagesa të kohë pas kohshme me çka ka ardhur deri te ndërprerja e parashkrimit, kjo për faktin se borxhi për shpenzimet e energjisë elektrike është borxh periodik dhe i njëjti arrin për pagesë pas përfundimit të çdo muaji, ndërsa afati 1 vjeçar i parashkrimit të paraparë me nenin 378 par.1 pika 1 të LMD për parashkrim rrjedh për secilin muaj pas momentit të përfundimit të atij muaji, që do të thotë se parashkrimi llogaritet për secilin muaj në mënyrë të veçantë, andaj në çështjen konkrete juridike borxhi është kërkuar për periudhën 01.01.2007 e gjer më 31.12.2008, ndërkaq propozimi për ekzekutim është paraqitur me dt.16.07.2009, i padituri në kundërshtimin e dt.28.03.2012, ka theksuar parashkrimin e borxhit, andaj edhe fakti tjetër se parashkrimi për shpenzimet e energjisë elektrike lidhet për secilin muaj në mënyrë të veçantë pas përfundimit të muajit, Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditëses për borxhin e lartpërmendur në shumë prej 530 Euro, duke marrë parasysh se propozimi për ekzekutim të këtij borxhi është paraqitur me datë 16.07.2009 çka do të thotë se më tepër se një vit pasi që ka arritur për pagesë secili kështë mujor.

Po ashtu janë të pa bazuara dhe të pa qendrueshme pretendimet ankimore të paditëses që kanë të bëjnë me atë se nuk ekziston parashkrimi i borxhit për shkak se me dispozitën e nenit 374 që parasheh që kërkesat reciproke të personave shoqërorë-juridikë nga kontrata e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata parashkruhen për 3 vjet, ndërsa në rastin konkret kemi të bëjmë me borxhin për shpenzimet telefonike i cili është borxh periodik e për të cilën vlen afati një vjeçar i parashkrimit konform dispozitës së nenit 378 paragrafi 3 të LMD-së, dhe në këtë drejtim kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka aplikuar të drejtën materiale.

Në këtë çështje juridike është zbatuar LMD "GZ e RSFJ nr.29/78, për arsye se në bazë të nenit 1057 të LMD (Ligji Nr.04/L-077)" i cili ka hy në fuqi nga dt. 20.12.2012, saktësisht është përcaktuar se dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërsa në çështjen konkrete juridike , marrëdhëniet e detyrimeve kanë lindur para hyrjes në fuqi të LMD të ri. Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në kuptim të nenit 195.1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVË NË PRISHTINË
Ac.nr.4882/2014 të datës 24.02.2016.

KRYETARI I KOLEGJIT-GJYQTARI
Nehat Idrizi d.v